

---

**REFERATE E KUMTESA**

---

**KATERINA TODOROSVKA****“LIDHJA REVOLUCIONARE SHQIPTARO-MAQEDONASE”  
DHE ORGANIZATA TË TJERA SHQIPTARO-MAQEDONASE  
NË SHEK. XIX DHE NË FILLIM TË SHEK. XX**

Në zhvillimin e marrëdhënieve shqiptaro-maqedonase në gjysmën e dytë të shek. XIX dhe në vitet e para të shek. XX një moment të veçantë përfaqëson krijimi i shoqërive, lidhjeve dhe bashkimeve të përbashkëta. Situata politike në Perandorinë Osmane, kushtet e padurueshme të jetesës si dhe pakënaqësia mbarëpopullore e cila rritej vazhdimisht, e rriste më tepër dëshirën e shqiptarëve dhe maqedonasve për një çlirim sa më të shpejtë. Nga ana tjetër, afërsia midis dy popujve e kushtëzuar nga pozita gjeografike, në mënyrë të pashmangshme çonte në bashkëpunim për realizimin e qëllimit, fitimit të lirisë. Në këtë drejtim punonin shumë patriotë shqiptarë dhe maqedonas në mes të cilëve për aktivitet të veçantë u shquan Stojan Vezenkov-i, Isaja Mazhovski etj.

Stojan Vezenkov-i ka qenë nga ata veprimtarë, i cili ka dhënë kontributin e tij moral, shoqëror dhe emotiv për krijimin dhe forcimin e miqësisë shqiptaro-maqedonase, për një afrim të sigurtë, lidhje dhe bashkëpunim të dy popujve fqinj<sup>1</sup>. Vezenkov-i “që herët i ishte kushtuar veprimtarisë revolucionare çlirimtare. Krahas emrit të tij maqedonas, ai e përdorte edhe emrin e tij konspirativ shqiptar: Zeka Bisov”<sup>2</sup>. Ai

---

<sup>1</sup> З. П. Тодоровска (Z.P. Todorovska), *Запис за Стојан Везенков*, 36. *Бигорски и научно-културни собири 1974-1975*, Скопје, 1976, 128-129. (Мë tej: Загорка Присагаиец Тодоровска, *Запис за...*).

<sup>2</sup> X. Андонов-Полјански, *Прилог кон македонско-албанските врски во минатото*, Годишен зборник, XXXIII/7 Скопје, 1982, 22-23; К. Цамбазовски, *Одбор на Србија и Македонија и македонското пришање од 1877-1881г.*, 36. Македонија во Источната криза 1875-1881, Скопје, 334. *Пërmbledhje vjetore*, XXXIII/7, Shkup, 1982, f.22-23; *Zb. Makedonija vo istoçnata kriza 1875-1881*, Skopje, 1982, 334.

aktivitetin e tij e kreu gjatë viteve 60 të shek. XIX kur bashkë me zëvendëskonsullin rus të atëhershëm në Manastir M.A. Hitrovo, “e shpallën të parët bashkimin shqiptaro-maqedonas në luftë kundër armikut të përgjithshëm-turqve”<sup>3</sup>.

Krahas Stojan Vezenkov-it, lidhjet dhe miqësinë shqiptaro-maqedonase i mbante dhe Isaja Radev Mazhovski, i cili e fliste mirë gjuhën shqipe dhe kishte vendosur lidhje të qëndrueshme me patriotët shqiptarë. Kryengritja e armatosur në Maqedoni dhe Shqipëri ishte domosdoshmëri për patriotët. Sipas tyre vetëm ajo do të realizonte çlirimin. Por, qëllimet dhe synimet e këtyre popujve i keqpërdornin propagandistët e vendeve fqinje dhe vendeve të tjera, të cilët shfaqnin interes për këtë pjesë të Ballkanit. Kështu, qeveria e atëhershme serbe përpiqej që nëpërmjet Stojan Vezenkov-it të ndërhynte në Shqipëri dhe në Maqedoni për disa aspirata të saj. Këto shërbyen si shkak që bashkëveprimi dhe aksioni i përbashkët për çlirimin e Shqipërisë dhe Maqedonisë të drejtohej jo vetëm kundër pushtimit osman por dhe kundër çdo pushteti të huaj. Duke punuar në drejtim të një veprimtarie të përbashkët, patriotët shqiptarë dhe maqedonas në mënyrë aktive morën pjesë për krijimin e Lidhjes Shqiptaro-Maqedonase të vitit 1887<sup>4</sup>. Aksionet e tyre udhëhiqeshin dhe drejtoheshin nga komandantë “të huaj”. Kjo lidhje revolucionare formoi një administratë qendrore e cila si

<sup>3</sup> З. П. Тодоросвка, *Затис за ...*, 129.

<sup>4</sup> И. Г. Сенкевич, *Нови материјали од архивот на М. А. Хитрово*, “Гласник” на ИНИ, IX/2, Скопје, 1965, 114. Theksohet veprimtaria e patriotëve maqedonas në vitin 1877 kur lindi plani i kryengritjes së përbashkët anti-turke në Shqipëri dhe Maqedoni. Për këtë citon dokumente të cilat janë botuar në vazhdim të artikullit të saj, pastaj në kujtimet e Mazhovskit dhe të një dokumenti nga Sektori i dorëshkrimeve në Institutin e letërsisë ruse të A.Sh. të BRSS. Për sa dimë ne, Isaja Mazhovski në kujtimet e tij nuk jep të dhëna për një aktivitet të tillë në vitin 1877, kurse dokumentet të cilat i sjell Senkeviq, kanë të bëjnë me vitin 1887. Kështu dokumenti i parë mban datën 3 tetor 1887 (në origjinal), dhe jo 3 tetor 1877. Besojmë se në këtë rast është bërë gabim gjatë shtypjes. Sigurisht pa marrë parasysh këtë, Томислав Тодороскви në: Спомените на Мажовски, (Kujtimet e Mazhovskit...), f.18, shkruan: “... gjatë vitit 1877 patriotët maqedonas dhe ato shqiptarë po përgatiteshin që të formojnë një organizatë të fshehtë politike me emrin “Lidhja revolucionare shqiptaro-maqedonase” në krye të cilës duhej të vihej majori Panica...”.

Të njëjtën të dhënë e shfrytëzon dhe X. Андонов-Полјански, *Прилог за...*, f. 26.

“udhëheqëse e lëvizjes ... përpunoi një thirrje dhe vepronte me emisarë në Maqedoni dhe Shqipëri për sqarimin e luftës së përbashkët”<sup>5</sup>. Administrata i dha një dokument Isak R. Opshtit me të cilin e autorizoi “në emër të Bes T’lultime skupenis” t’i japë shpjegime për gjendjen e Lidhjes në atë kohë atij, tek i cili e patën dërguar për këtë qëllim dhe askujt tjetër<sup>6</sup>. Vërtetësia e dokumentit me datë 03.10.1887, është konfirmuar me vulë të Lidhjes në të cilin është shënuar parulla “Liri a vdekje” dhe në vend të nënshkrimit të personit të besuar qëndron vetëm Vendi Qendror. Sipas gjuhës dhe shkrimit të këtij dokumenti, mendojmë se pas Vëndit Qendror fshihet emri i kryeqytetit të Bullgarisë, Sofjes. Edhe pse për këtë nuk kemi të dhëna të sigurta, disa fakte, të cilat do t’i lexojmë në tekstin e mëposhtëm, flasin në dobi të kësaj teze. Sipas Senkeviq, dokumenti i është dhënë Isaja Radev Mazhovskit (Isak R. Opshti), i cili ishte një nga emisarët e Lidhjes shqiptaro-maqedonase, dhe ky konstatim përputhet me emrin që Isait ia përmend Jastrebov, konsulli rus në Selanik, Isak Radulev<sup>7</sup>. Sigurisht nëpërmjet këtij emisari ose ndonjë tjetri, administrata qendrore ka dërguar një shpallje drejtuar popullit shqiptar, shkruar me shkronja latine, në dialektin e gegërishtes, në të cilën bëhet thirrje për pjesëmarrje në Lidhje. Në thirrje thuhet:

“Vëllezër,

Pas shumë përpjekjeve të ndërmarra për t’i ndihmuar atdheut tonë Shqipërisë, ne arritëm në përfundimin se ka vetëm një mjet për arritjen e fitores. Ky mjet është bashkimi me të afërmit tanë maqedonasit dhe aksione të përbashkëta me ta për çlirimin e atdheut tonë të lashtë e të shumëvuajtur. Maqedonasve që gjenden në principatën bullgare dhe atyre që jetojnë në Maqedoni, zoti i ndihmoi duke ua dërguar njeriun me emrin Panica<sup>8</sup>, i cili u shqua si hero, njëlloj si dikur u shqua hero i ynë kombëtar Gjergj Kastrioti (Skënderbeu). Ky njeri është besnik në veprën e tij

<sup>5</sup> X. Андонов-Полјански, *Прилог кон македонско-албанските врски во минатото*, “Историја”, III/1 Скопје, f.84.

<sup>6</sup> ДАРМ мф.559, мф.1044, мф. 1048 (dokumente nga arkivi historik i Leningradit, f.325; nr.202.

<sup>7</sup> И. Г. Сенкевич, *Нови материјали...*, f. 114-115.

<sup>8</sup> Majori Kosta Panica, i ashtuquajtur “komandant i të gjithë dukëve maqedonas”. në kohën e luftës serbo-bullgare (1885) komandonte me repartet e vullnetarëve maqedonas, që sigurisht i mundësoi që ta marrë këtë epitet. Disa shkencëtarë janë të mendimit se bëhet fjalë për Todor Panicën (1879-1925). Megjithatë duke marrë parasysh vitin e lindjes, ne e hedhim poshtë këtë tezë.

prandaj të gjithë maqedonasit u mblodhën rreth tij dhe njëzëri e njohin si komandantin e tyre. Edhe ne kur morëm vesh për këtë, u gëzuam pa masë dhe kemi shumë respekt për këtë vëlla, Skënderbeu i dytë, dhe nën udhëheqjen e tij e filluam veprën tonë të shenjtë. Atij i ndihmon zoti dhe zemra e tij është plot me ideale fisnike dhe ne, duke u bashkuar vëllazërisht me maqedonasit, e filluam punën. Nën komandën e majorit Panica, ne do të luftojmë për çlirimin e atdheut të maqedonasve dhe të atdheut tonë pa dallim feje, sepse të gjithë jemi vëllezër në një truall dhe na bashkon një ide.

Për këtë qëllim këtu u krijua “Lidhja Revolucionare Shqiptaro-Maqedonase”, si dhe u hartua programi dhe Kushtetuta. Ne po jua dërgojmë Kushtetutën e Lidhjes sapo të marrim një përgjigje pozitive të kësaj letre.

Në qoftë se e dini gjeografinë e Maqedonisë dhe Shqipërisë, historinë e tyre në të kaluarën, afërsinë e tyre, zakonet dhe interesat e tyre politike dhe nëse na besoni, atëherë zgjidhni veprat tona dhe bashkohuni sa më shpejt me ne dhe na e tregoni ndihmën tuaj.

E shohim të arsyeshme që t’ju tregojmë se krijimi i “Lidhjes Revolucionare Shqiptaro-Maqedonase” me parullën “Liri a vdekje” është rruga e vetme që do ta ndihmojë veprimtarinë tonë. Ne shpesh flisnim për të, por nuk e realizuam, kurse tani përfundimisht e realizuam këtë veprimtari.

Veprimtarinë tonë për çlirim do ta realizojnë shqiptarët së bashku me maqedonasit, duke vepruar së bashku pa lajmërimë të ndryshme por sipas një Kushtetute, me një flamur dhe do të luftojmë që të vendosim vetëqeverisjen në të dy territoret tona ... përveç kësaj ekzistojnë dhe shumë njerëz fisnikë të cilët do të na ndihmojnë në veprën tonë të shenjtë dhe në mënyrë të sinqertë kujdesen për vendosjen e vetëqeverisjes në atdheun tonë.

Duke vepruar bashkërisht si vëllezër, ne mundemi shumë shpejt ta largojmë drejtuesin e madh prej Stambolli dhe do të arrijmë që Evropa të jetë në anën tonë dhe t’i njohë të drejtat tona. Prandaj të besohet se civilizimi ynë do të bëhet i njohur dhe do të na ndihmojnë dhe s’do të ketë më kush të na mbajë në robëri në të cilën ndodhemi prej disa shekujsh. Në Bullgari ekziston motoja se “Përkushtimi e bën njeriun të madh”. Dhe ne do ta marrim këtë moto dhe në emër të Zotit do t’i fitojmë të drejtat tona. Duke ju njoftuar për të gjithë këtë ne ju ftojmë të bashkoheni me ne nën flamurin krenar të Shqipërisë dhe Maqedonisë.

Para së gjithash ju informojmë se nuk kemi shumë pretendime: ne nuk kërkojmë as mbretëri, as principatë, ne nuk duam që Shqipëria dhe Maqedonia të bien nën pushtetin bullgar, serb apo grek. Por ne duam që Shqipërisë dhe Maqedonisë t'ju jepet autonomi, edhe në rast se mbeten nën pushtetin e Sulltanit. Me një fjalë ne duam të kemi administratën dhe gjykatën tonë ... në Shqipëri le të komandojnë shqiptarët, kurse në Maqedoni maqedonasit, edhe pse kjo do të ndodhë nën pushtetin suprem të Sulltanit.

Në emër të “Betimit për besnikëri të Shqipërisë”, betohemi në vërtetësinë e atyre që ekspozuam në këtë dokument. Jini të kujdesshëm dhe mos ua tregoni këtë dokument njerëzve jo të besuar, por vetëm shqiptarëve besnikë. Ne presim nga ju të tregoni dashuri për atdheun dhe popullin tonë, kundrejt veprës sonë të shenjtë dhe presim që, për një periudhë sa më të shkurtër të na ktheni përgjigje pozitive.

Vëllezërit tuaj të përzemërt nga gjaku dhe betimi”<sup>9</sup>.

Krahas kësaj thirrjeje ishte hartuar dhe një plan luftarak prej nëntë pikash, sipas të cilit duhej të udhëhiqeshin aktivitetet e kryengritjes. Në tekstin e planit thuhej:

“1. Një kryengritje e përgjithshme në Shqipëri e Maqedoni (do të mundësojë – K.N.) nga njëra anë Turqia të angazhohet në punët e veta të përgjithshme dhe se dyti, do të tërhiqte kundër vetes jo më pak se 400 000 veta të ushtrisë turke.

2. Nëpërmjet kryengritjes në Shqipëri dhe Maqedoni jo vetëm që do të ruhen kufijtë e Malit të Zi dhe Greqisë, në Shqipëri do të sigurohet mbrojtja e trojeve të tyre, dhe përveç kësaj kjo do të ndihmojë që jo më pak se 50 000 vetë të hyjnë në Bosnjë e Hercegovinë.

3. Bullgarët janë një popull i cili është i gatshëm të sakrifikojë gjithçka për bashkimin e tij. Ata janë të gatshëm për çdo lloj sakrifice, vetëm që të realizojnë marrëveshjen e Shën Stefanit për të marrë portin e Selanikut dhe ata të gjithë, i madh e i vogël, e kuptojnë plotësisht rëndësinë e tij për Bullgarinë. Kundër kësaj munden të dalin vetëm gjermanët dhe ajo qeveri bullgare, që do të marrë përsipër të përballojë pakënaqësinë popullore. Një lëvizje serioze shqiptaro–maqedonase (e përgjithshme) sigurisht nuk ka për ta lënë gjakftohtë dhe patronin e

---

<sup>9</sup> ДАРМ мф.559. Teksti i Apelit është shpallur në tërësi në *Документи за борбата на македонскиот народ за самостојност и за национална држава*, f.274-276, f.117-118. Dhe ne e prezantuam tërësisht që të kuptohet më mirë programi i Lidhjes.

tanishëm pa të kaluar, i cili ose duhet të bëjë atë që e bëri padroni i kaluar ose duhet ta lëshojë Bullgarinë. Për këtë ne garantojmë me siguri.

4. Që të përgatitet një kryengritje serioze në Shqipëri dhe Maqedoni janë të domosdoshme, përveç sasive të duhura të parave, jo më pak se 200 000 pushkë, rreth 20 topa (edhe këto të shoqëruara me rezerva në ushqime dhe veshmbathje). Oficerët duhet të jenë me grada të larta; të cilët të kenë njohuri për luftërat partizane në Kaukaz. Dhe kryesorja, duhen disa oficerë me gradë Gjeneral Shtabi dhe artilierë, si dhe gjithashtu edhe doktorë me sasi të duhura të ilaçeve (oficerët e emëruar duhet të jenë njerëz me ndjenja patriotike, pasi ata kanë rëndësi më të madhe për këto vende).

5. Për suksesin e kryengritjes garantojmë ne. Por për këtë duhet të na lajmërohet së paku një muaj përpara se ajo të shpërthejë, për të siguruar mbështetje nga ana e bullgarëve për përgatitjen e çetave, të cilat në atë kohë duhet të kalojnë nga Bullgaria në Maqedoni, për shpenzime udhëtimi për agjentët dhe udhëheqësit vendas. Për realizimin e një kryengritjeje të vogël në Shqipëri dhe Maqedoni si dhe për organizimin fillestar të kryengritjes nevojiten rreth 5 000 napolona (të dërguara - K.N.) nëpërmjet një njeriu tek i cili keni besim edhe ju edhe ne. Sasia e rezervave duhet të llogaritet për 300 000 veta dhe për 8 muaj.

6. Si fillim vetëm  $\frac{1}{4}$  e sasisë të mësipërme mund të dërgohet në Shqipëri, kurse pjesa e mbetur të mbahet në Mal të Zi, nga ku do të merret sasia e duhur e parave në të ardhmen.

7. Ne jemi të përgatitur të fillojmë çdo ditë e orë me veprimtari duke u udhëhequr sipas planit i cili do të jepet dhe të takohemi në vendin e caktuar në Shqipëri. Ky duhet të merret rezervat. Vendin e përcaktuar do t'ju them sapo të marr pëlqimin tuaj se duhet të veprohet dhe sapo t'i marr mjetet fillestare.

8. Kushtet dhe planet e detajuara për veprim do të bëhen të njohura pas marrëveshjes së përbashkët. Në këtë moment personi nëpërmjet të cilit mund të kontaktojmë dhe tek i cili kemi besim të plotë është i dërguari P. Konoblofi, i cili është bashkëpunëtor i vjetër.

9. E konsiderojmë si të domosdoshme t'ju lajmërojmë se tashmë janë të gatshme – në Shqipëri 40 000 pushkë të tipit “Martini” dhe “Shnajder” dhe 20 000 të tilla në Maqedoni. Përveç kësaj në Maqedoni ka dhe 2 000 pushkë të tipit “Krimki” me sasinë e duhur të fishekëve. Atje ka komitete të organizuara, të cilat ndahen në qendrore dhe të pavarur të cilat e kanë numrin e nevojshëm të agjentëve, udhëheqësve

dhe shoqërive. Fishekët për “Shnajder” dhe “Martini” nuk janë të mjaftueshëm”<sup>10</sup>.

Duke e analizuar planin luftarak të Lidhjes, vëmendjen e fokusojmë në disa pika, të cilat na ndihmuan të formojmë mendimin tonë për këtë tekst. Sipas vlerësimeve ushtarake, në shumicën e pikave, arrijmë në përfundimin se tekstin e ka hartuar një person që merr vesh nga këto punë. Meqenëse në apel të Lidhjes përmendet majori (Kosta – K.N.) Panica si një komandant i njohur nga të gjithë prijësit (vojvodët) në Maqedoni, dhe si të tillë e njihnin dhe disa shqiptarë, arrijmë në përfundimin se planin luftarak të Lidhjes, e ka hartuar ose ai personalisht ose ndonjë bashkëpunëtor i afërt i tij.

Teksti në pikën e tretë tregon qartë se prapa tij qëndrojnë ithtarët e politikës zyrtare bullgare, e cila gjithmonë e ëndërronte për Traktatin e Shën-Stefanit. Por gjatë hartimit të planit shkohet më larg se kërkesat e Shën-Stefanit, portin e Selanikut, i cili në marrëveshjen e përmendur nuk ekziston.

Në pikën e pestë të tekstit përmendet krijimi i çetave jo vetëm në Bullgari, por sigurisht dhe në Rumani, ku në atë kohë kishte shumë emigrantë ekonomikë nga Maqedonia dhe Shqipëria. Këto çeta duhet të kalonin nga Bullgaria në Maqedoni dhe atje të përfshiheshin në kryengritjen e provokuar. Hartuesit e planit me siguri i kanë pasur parasysh ndjenjat patriotike të emigrantëve në Rumani, që vinin nga Maqedonia dhe Shqipëria, kur planifikonin krijimin e çetave “çlirimtare”. Shtojmë pyetjen pse është zgjedhur emri “Lidhja Revolucionare Shqiptaro-Maqedonase” kur dihet se në atë kohë në Maqedoni takoheshin vetëm termat shoqata, shoqëri dhe bashkime, por jo dhe Lidhje? Mendojmë se emri Lidhje është dhënë qëllimisht që të tërhiqet një numër sa më i madh i popullsisë shqiptare për të cilët termi Lidhje ishte i njohur nga Lidhja e Prizrenit. Në bazë të këtyre dokumenteve, arrijmë në përfundimin se krijimi i “Lidhjes Revolucionare Shqiptaro-Maqedonase” nuk ka kaluar pa ndikimin e qeverisë bullgare, austro-hungareze, e cila kishte synime kundrejt Shqipërisë, si dhe prej asaj ruse që në atë kohë ishte e shqetësuar për (mos) ndikimin e saj në Ballkan. Të gjithë këta, që të mënjanonin konfliktin e drejtpërdrejtë me Perandorinë Osmane, por

---

<sup>10</sup> ДАРМ мф.559, док.бр.203.

dhe njëkohësisht t'i realizonin ambicidet e veta, synonin ta shfrytëzonin miqësinë dhe bashkëpunimin shqiptaro-maqedonas<sup>11</sup>.

Në fillimet e formimit të Lidhjes, patriotët shqiptarë dhe ata maqedonas me siguri besonin në sinqeritetin e synimeve miqësore të Panicës, për të cilin tregues më i mirë është dhe thirrja e Lidhjes. Megjithatë këto qëllime ishin dredhuar, kurse ndjenjat patriotike ishin shfrytëzuar për të provokuar një kryengritje, e cila që në fillim ishte e destinuar në humbje. Asnjë kryengritje pa mbështetjen e popullsisë nuk mund të ketë sukses. Sipas Poljanskit “aksionet e aktorëve kryesorë të kësaj lëvizjeje, midis të cilëve ishte dhe Mazhovski, ishin penguar nga pushteti turk dhe ishin burgosur<sup>12</sup>. Edhe pse kjo “Lidhje Revolucionare Shqiptaro Maqedonase” në punën e saj ishte mbështetur nga të huajt, në idetë e saj ajo, në mënyrë indirekte, luajti një rol të rëndësishëm në forcimin e lidhjeve shqiptaro – maqedonase. Fakti se Isaja Mazhovski, si emisar i Lidhjes, vazhdimisht kontaktonte me parinë dhe patriotët shqiptarë na bën të mendojmë se “qëllimet dhe detyrat e Lidhjes të përfaqësuara në shpalljen e saj, edhe pse ofrojnë një program minimal të veprimitarisë revolucionare, shënon një hap përpara në krijimin e luftës revolucionare shqiptaro-maqedonase<sup>13</sup>.

Gjendja e vështirë në Shqipëri dhe Maqedoni e nxiti popullsinë që vitin 1888 të krijojë një “Këshill shqiptaro–maqedonas”, me qëllim që së bashku të luftojnë në realizimin e qëllimeve të veta çlirimtare<sup>14</sup>.

Vazhdimin e aksioneve me interes të përbashkët e shikojmë edhe në përpjekjen e bërë në Rumani, në vitin 1893, në mes të emigrantëve shqiptarë dhe maqedonas, për botimin e gazetës të quajtur “Albano-Maqedonia”<sup>15</sup>. Për të njëjtën gazetë Sokolova shkruan: “Më 25.12.1892 (06.01.1893) në Rumani del në greqisht dhe shqip numri i vetëm i

<sup>11</sup> Në dobi të mendimit tonë për punën e lidhjes flet dhe Mazhovski. “Në vitin 1887, majori Panica më dërgoi në Bukuresht (Rumani) që të takohem me përfaqësuesin rus, zotin Hitrovo kujt duhet t'i komunikoj se punojmë bashkë me shqiptarët për lirinë dhe pavarësinë e të dy vendeve: Maqedonisë dhe Shqipërisë. Z. Hitrovo e miratoi punën tonë dhe tha që duhet të presim lajmërim nga Rusia për fillimin e kryengritjes”. И. Р. Мажовски, *Вспоминанија*, Софија, 55.

<sup>12</sup> X. Андонов-Полјански, *Прилог кон...*, II, 85.

<sup>13</sup> *Po aty*, 27.

<sup>14</sup> A. Nikić, *Stanje u severnoj...*, 205.

<sup>15</sup> X. Андонов-Полјански, *Прилог кон...*, 27.

gazetës Albano–Maqedonia, pronësi e Steflu al Dancei Makedon dhe kompani”<sup>16</sup>.

Në studimet tona të deritanishme jemi njohur me dy numra të gazetës “Albano–Maqedonia”, e cila është botuar në Bukuresht. Artikulli i parë i numri të parë mban datën 24 dhjetor 1893, është shtypur në gjuhën rumune, kurse numri i dytë është botuar më 5-6 janar 1894 në gjuhën greke. Redaktor dhe pronar i gazetës ishte Stefan Damchev Makedon.

Simbolika e ilustrimit të faqes së parë të gazetës<sup>17</sup> më mirë është shprehur me shënimin “vëllazëria shqiptaro-maqedonase”, në të cilën krahas idesë për një shtet shqiptaro-maqedonas shkruhet: “ne kemi një atdhe të pasur e të madh me pasuri natyrore të cilat i përmban atdheu më i dashur dhe më i kënduar dhe kush nuk do të donte t’i zotërojë, kush nuk do të jetojë në bollëk dhe të jetë i zoti i dy deteve, Adriatikut dhe Egjeut, ku mund të bëjmë një bum tregtar...”<sup>18</sup>.

Në numrin e 24 dhjetorit të vitit 1893, botuar në gjuhën rumune lexojmë “ne të grupuar rreth idesë për një vëllazërim shqiptaro-maqedonas dhe për liri, pa e anashkuar të vërtetën, nuk do të lutemi para pronarëve tanë, të cilët na mbajnë në robëri ... Duhet që në mënyrë të sinqertë t’i tregojmë dëshirat intime të popujve shqiptaro–maqedonas pa i dëmtuar të drejtat e askujt ... Prandaj, me të drejtë do t’ju tregojmë sundesve se nuk mundet të jetë aktuale më kjo gjendje e punëve shqiptaro-maqedonase dhe në interes të tyre është të kuptojnë se duhet ta lehtësojnë gjendjen në të cilën gjendet populli dhe me të cilën ai nuk mund të pajtohet, tani më shumë se çdo herë tjetër”<sup>19</sup>.

<sup>16</sup> Б.Соколова, *Албански възрожденски печат в България*, Софија, 1979, f.37.

<sup>17</sup> Ilustrimi i faqes së parë të gazetës, e simbolizon bashkësinë e Shqipërisë dhe Maqedonisë, në figurë jepen dy vajza me flokë të gjatë të gërshtuar (që asociojnë Shqipërinë dhe Maqedoninë), të zëna për duarsh të cilat u janë lidhur me zinxhirë, të përforcuara me një peshë (që e përfaqëson pushtetin osman). Të dy vajzat qëndrojnë në truall të përbashkët, kurse prapa tyre ndodhen dete. Mbi kokat e vajzave përveç emrit të gazetës, është shkruar parulla “vëllazërim e liri” mbi të cilën shkëlqen ylli i lirisë. Në sfond janë vizatuar engjëj, të cilët u japin jetë dhe forcë, kurse bajoneta e pushkës, në fund të pikturës e tregon frymën luftarake të Shqipërisë dhe Maqedonisë.

<sup>18</sup> ДАРМ МФ, СIII/1227, Albano-Makedonia, 24 dekemvri 1893, 2.

<sup>19</sup> *Po aty*, 25-6, I. 1894, 2.

Por në numrin e “Albano-Maqedonisë” të 25 dhjetorit - 6 janarit të vitit 1894, në gjuhën greke, janë pasqyruar shumë shkrime, nga të cilët interes të veçantë zgjon ai me titull “Diskutime për autonominë shqiptaro-maqedonase”. Në të autori shkuan: “Shpirtin tonë nuk e ngarkojmë me antagonizma gjatë tregimit të qëllimeve tona, sepse (vazhdimisht - K.N.) qarkullon kjo dëshirë jona për autonomi shqiptaro-maqedonase ... Të gjithë së bashku, shqiptarët dhe maqedonasit, kemi dëshirë për një jetë të përbashkët, në dallim të asaj që kanë fqinjët tanë...”<sup>20</sup>.

Edhe në Londër në vitet 1893-1894 u bë përpjekje për formimin e një lidhjeje të përbashkët, e cila përfaqëson një moment të ri në zhvillimin e lidhjeve shqiptaro-maqedonase. Kjo lidhje në dallim nga ajo e mëparshme quhej “Lidhja Nacionale-Qendrore Shqiptaro-Maqedonase”. Megjithatë aktiviteti i saj u intensifikua veçanërisht disa vite më vonë. Si rezultat i kësaj veprimtarie, më 10 nëntor 1898, doli në dritë shpallja e njohur si “Shpallje e Lidhjes Nacionale-Qendrore Shqiptaro-Maqedonase”<sup>21</sup>. Shpallja theksoi se qëllimi i saj ishte hedhja dritë mbi thelbin e problemit shqiptaro-maqedonas para opinionit evropian. Krahas kësaj është sqaruar domosdoshmëria e punës në fshehtësi e “Lidhjes Nacionale-Qendrore Shqiptaro-Maqedonase”. Në pesë pikat e saj kërkohet pavarësia për Shqipërinë dhe Maqedoninë, si dhe krijimi i konfederatës, në të cilin do të futen të gjithë popujt e këtyre zonave pa dallim emri, feje dhe gjuhe. Hartuesit e shpalljes në mënyrë energjike i kundërshtonin dhe dënonin ndërhyrjet e huaja në Maqedoni dhe Shqipëri. Në këtë mënyrë Lidhja arriti të tërheqë një numër të madh simpatizantësh dhe mbështetësish, duke filluar që nga Ildiz Qoshk (rezidenca e sulltanit) deri te kasollja më e thjeshtë në Shqipëri e Maqedoni. Veprimtarët e Lidhjes, e injoronin çdo veprimtari që kryhej pa dijeninë dhe mbështetjen e tyre<sup>22</sup>. Në organizimin e kësaj lidhjeje u shquan disa veprimtarë shqiptarë dhe maqedonas. Midis tyre një rol të veçantë ka luajtur Stefan Damchev Makedon nga Manastiri, i cili fliste shqip dhe i ishte përkushtuar veprimtarisë çlirimtare shqiptaro-

<sup>20</sup> *Документи са борбата...*, Т. I, 341.

<sup>21</sup> *Ро ату*, f.341-342.

<sup>22</sup> X.Андонов-Полјански, *Прилог кон...*, f.28; Б. Ристовски, *Димитрија Чуповски (1878-1940) и македонското научно-литературно Другарство во Петроград*, Т. I, Скопје, 1978, 10.

maqedonase<sup>23</sup>. Kësaj Lidhjeje i paraprinte një propozim (memorandum) për vendosjen e autonomisë administrative në Shqipëri dhe Maqedoni. Si dhe më parë, në Lidhjet shqiptaro-maqedonase u përzje Sofja zyrtare, ku ishte formuluar propozimi i verës së vitit 1898 dhe i ishte drejtuar sulltanit dhe shtypit evropian<sup>24</sup>. Propozimi (memorandumi) i ishte dorëzuar sulltanit nga shqiptari Jusuf Ali, me prejardhje nga Dibra, i cili për një kohë të gjatë qëndroi si emigrant në Sofje. Nëpërmjet këtij memorandumi të hartuar në 23 pika, edhe një herë politika bullgare u përpoq të luajë rolin e padronit në lidhje me statusin e Maqedonisë dhe Shqipërisë në përbërje të Perandorisë Osmane. Për shkak të “shqetësimit” të madh për këto vende “qeveria e Bullgarisë ka angazhuar disa persona nga emigracioni shqiptar dhe maqedonas në Bullgari për veprimtari të përbashkët në drejtim të realizimit të autonomisë së Maqedonisë dhe Shqipërisë”<sup>25</sup>. Pas shqyrtimit të tekstit integral të propozimit Rahimi konstaton se “për ndonjë marrëveshje midis këtyre dy shteteve as që mund të bëhet fjalë”<sup>26</sup>.

Një memorandum i tillë në mënyrë sfiduese ka vepruar mbi emigracionin shqiptar dhe maqedonas në Londër dhe në mes të aktivistëve të “Lidhjes Nacionale-Qendrore Shqiptare-Maqedonase”.

<sup>23</sup> Ш. Рахими, *Меморандум доставен до султанот и европскиот печат за создаване автономија на Алванија и Македонија 1898 година и неговата политичка задница*, “Историја” IX/2 Скопје, 1973, f.215.

<sup>24</sup> *Po aty*, f.216. “Jusuf Ali beu, që u përmend më lart, si patriot shqiptar edhe pse ishte mysliman për nga besimi, nga vitet 20-30 e këtej me të drejtë është i pakënaqur me drejtimin e keq të pushtetit turk dhe është një emigrant në Bullgari nga ku në gazetën e tij në të gjitha faqet e kritikon administratën e lartë turke, pashallarët, valitë etj., të cilët janë verbuar nga shkëlqimi i arit, i shesin interesat e dikur perandorisë së lavdishme osmane, të popullit trim turk, nga frika e të cilëve para ca kohe dridhej gjithë Evropa, gjithë bota e krishterë.

Ky redaktor, në gazetën e tij (Itifak - K.N.) ... ka vendosur një artikull të gjatë, tërësisht kushtuar popullit shqiptar, në të cilin me shumë mençuri i këshillon bashkatdhetarët shqiptarë që të mos lidhin asnjë lloj marrëveshjeje, bashkimi me kombe të huaj si me serbët, rumunët, austriakët, grekët dhe as me bullgarët e principatës Bullgare, pasi të gjithë këto kombe janë çliruar nga robëria, jetojnë të pavarur dhe ëndërrojnë vetëm për zgjerimin e territoreve të tyre me territore të Maqedonisë dhe Shqipërisë, të cilat akoma janë nën sundimin perandorisë turke”. AM МФ.Глас Македонски, 15 Окт.1897.Софија, 43, 1.

<sup>25</sup> Ш. Рахими, *Меморандум доставен...*, f.215.

<sup>26</sup> *Po aty*, f.218.

Aktivitetin e saj Lidhja, e cila e ndërroi emrin e saj në “Lidhja Nacionale Shqiptaro–Maqedonase”, e intensifikoi në fillim të shekullit XX<sup>27</sup>. Përkatësisht, në vitin 1902 komiteti i saj ekzekutiv ka botuar një shpallje, e cila është shpërndarë në vende të banuara me shqiptarë dhe maqedonas, nga aktivitet e Lidhjes: Stefan Damçev dhe Jashar beu<sup>28</sup>. Nga përmbajtja e shpalljes duket qartë se përfaqësuesit e komitetit ekzekutiv të Lidhjes Shqiptaro-Maqedonase ishin njerëz me të cilët kontaktonte pushtetit i atëhershëm osman<sup>29</sup>. Krahas faktit se kjo shpallje ndryshonte nga të mëparshmet, të cilat kërkonin çlirim të plotë të Maqedonisë dhe Shqipërisë, përsëri mbetet me interes theksimi i luftës së përbashkët, si rrugë për realizimin e dëshirave të përbashkëta si dhe i drejtohej direkt si popullsisë shqiptare ashtu dhe asaj maqedonase<sup>30</sup>. Në këtë Lidhje aktivitet të veçantë ka shfaqur E.L. Lazareviqi, i cili e udhëhiqte “Komitetin për autonomi të Maqedonisë”. Sipas njohurive tona të deritanishme ky Komitet ishte një dorë e zgjatur e Vëllazërisë maqedonase nga Athina, krijuar në vitin 1873. Komitete të tilla ishin krijuar në Beograd, Bukuresht dhe Londër. Komiteti për autonomi të Maqedonisë botoi “Projektin për autonominë e Maqedonisë, Shqipërisë, Serbisë së Vjetër dhe Odrim” të përbërë nga 12 nene<sup>31</sup>. Për herë të parë konceptimi i këtij projekti ishte botuar në numrin e parë të organit L'Autonomie, më 10 maj 1902. Gazeta dilte dy herë në muaj, gjithsej dolën 5 numra. redaktori i saj ishte Lazareviqi, pseudonimi i të cilit Çernutcki takohet shpesh në faqet e gazetës<sup>32</sup>. Sipas projektit parashikohet krijimi i provincave autonome nën pushtetin direkt të sulltanit.

<sup>27</sup> X.Андонов-Полјански, *Прилог кон...*, f. 28.

<sup>28</sup> Sh. Rahimi, *Komiteti i lidhjes shqiptaro-maqedonase në Londër më 1902*, në “Gjurmime historike të Rilindjes Kombëtare”, Prishtinë, 1986, f.345.

<sup>29</sup> Teksti i apelit është dhënë dhe në *Документи са борбата...*, V.I, 355-356, X.Андонов-Полјански, *Прилог кон...*, f. 86-87.

<sup>30</sup> Sh. Rahimi, *Komiteti i ...*, f.347.

<sup>31</sup> X.Андонов-Полјански, *Прилог кон...*, f.29; X.Андонов-Полјански, *Еден проект за автономија на Македонија од 1903 г.*, “Пасгледи”, II/14, Скопје. Teksti i projektit është botuar dhe në *Документи са борбата...*, V.I, f.356-357.

<sup>32</sup> X. Андонов-Полјански, *Еден проект...*, X.Андонов-Полјански, *Британска библиографија за Македонија*, Скопје, 1966; Sh. Rahimi, *Komiteti i ...*, f.343. Ne, gjatë punimit të gazetës në asnjë numër nuk e takuam pseudonimin Çernucki.

Në numrin e dytë sqarohet se Komiteti për autonomi të Maqedonisë dhe Shqipërisë përbëhet kryesisht prej përfaqësuesve të këtyre dy vendeve. Në përbërje të tij nuk kishte “të huaj” dhe as nuk ishte krijuar nga ndonjë grupim politik apo ndonjë vend<sup>33</sup>.

Numri i tretë, krahas mendimeve për çështjen shqiptare pasqyron dhe raportet e dërguara pranë komitetit maqedonas nga Prizreni, Ohri, Selaniku, Shkupi, Konstantinopoli dhe Adrianopoli<sup>34</sup>. Duke e shfletuar gazetën “L'Autonomie” (Autonomia), ndeshemi me ide të cilat propagandohen si qëllime të Komitetit. “Qëllimi ynë, idetë tona janë autonomia e Shqipërisë dhe e Maqedonisë dhe krijimi i unionit doganor i të gjitha vendeve të vogla fqinje si Mali i Zi, Serbia, Bullgaria dhe Greqia. Të gjithë këto vende kanë nevojë për ne dhe ne kemi nevojë për ta. Ky union doganor, i cili mund të quhet Konfederata Ballkanike, do t’ju japë Serbisë dhe Bullgarisë dalje në det, Greqisë ultësirat e pasura të Maqedonisë. Dhe në vend që Maqedonia e Shqipëria të jenë vatra të vazhdueshme armiqësie, mund të bëhen burime pasurie e ekonomie të pasur të vendeve fqinje”<sup>35</sup>. Këto qëllime paqedashëse të Komitetit shihen dhe në komunikatën në të cilën kërkohet plotësimi i përfundimeve të sjella në Berlin dhe në konferencën internacionale në Stamboll. Një kërkesë e tillë është shtruar në 10 pika të cilat i përfshijnë njëkohësisht bazat e konstituimit dhe organizimit të Maqedonisë së ardhshme<sup>36</sup>.

Sipas njohurive të prezantuara deri tani, arrimë në konkluzionin se në periudhën nga Kongresi i Berlinit deri në kryengritjen e Ilindenit. Lidhjet shqiptaro-maqedonase forcoheshin me krijimin e Lidhjeve, shoqërive të përbashkëta si dhe me botimin e gazetave të përbashkëta etj.

Lidhjet tradicionale e individuale midis maqedonasve dhe shqiptarëve ishin shumë të rëndësishme për të dy popujt, megjithatë ato nuk ishin aq të fuqishme sa t’u kundërviheshin interesave të huaja, të cilat në çdo mënyrë tentonin të ndikonin në zgjidhjen e problemit shqiptar dhe maqedonas. Nga ana tjetër, patriotët shqiptarë dhe maqedonas shpresonin se në bashkëpunim me popujt e tjerë të Gadishullit Ballkanik dhe qeveritë e tyre, do të fitonin autonominë, e cila përfaqësonte fazën e parë drejt çlirimit të plotë nga robëria osmane. Shpresa të tilla ishin ndërprerë sepse shtetet fqinje dhe Fuqitë e Mëdha

<sup>33</sup> ДАРМ мф.1040, "L'Autonomie", nr.2, maj 1902, f.1.

<sup>34</sup> Po aty, "L'Autonomie", nr.3, 15 qershor 1902, f.1-5.

<sup>35</sup> Po aty, nr.4, 15 korrik 1902, f.5.

<sup>36</sup> Po aty, 1 korrik 1902, f.3.

synonin të vendosin pushtetin e tyre në Maqedoni dhe Shqipëri. Kjo bënte që shpesh të arriheshin efekte të kundërta si te maqedonasit, ashtu dhe te shqiptarët, të cilët çlirimin e atdheut të tyre kërkonin ta zgjidhnin në mënyrë të pavarur.